



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
REKTORI

Nr. 3871 prot.

Shkodër, më 23. 11. 2018

Lënda : Publikim njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike

Drejtar : Agjensisë së Prokurimit Publik


pranë

Këshillit të Ministrave

Tiranë

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm, bashkëlidhur po ju dërgojmë Njoftimin tonë për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike të rradhës. Sipas kërkesës tuaj, po ju dërgojmë edhe cd me variantin elektronik të njoftimit.

REKTORI
Prof.dr. Adem Bekteshi



Konceptoi : G.Boriçi, dt.22.11.2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI”
REKTORI**

Nr. prot.

Shkodër, më .2018

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë të interesuarit se në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” shpallet konkursi për vend të lirë pune në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Departamenti i Biologjisë dhe kimisë, për pozicionin Lektor/e me kohë të plotë.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere specifike :

1. Të kenë kryer të gjitha ciklet e shkollimit me kohë të plotë në specialitetin “Biologji” ose “Biologji-kimi”.
2. Të kenë kryer ciklin e pare të studimeve në sistemin me kohë të plotë, në degën “Biologji” ose “Biologji-kimi” me notë mesatare mbi 9.
3. Të kenë kryer ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë me diplomë “Master i Shkencave” me drejtim Biologji me notë mesatare mbi 9.
4. Të kenë kryer ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë me diplomë “Master i Shkencave” ose “DIND” (300 kredite) në profilin “Biologji” ose “Biologji-Kimi”, me notë mesatare jo më të ulët se 9. Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga MASR.
5. Të kenë noten mesatare të lëndëve për të cilat konkurojnë mbi 9.
6. Të kenë titull akademik apo gradë shkencore “Doktor” në Biologji, preferohet me aktivitet të pasur botues dhe drejtim në “Botanikë”.
7. Të kenë të mbrojtur njërin nga gjuhët e huaja të BE-së me notë jo më të ulët se 8 ose të ketë mbrojtur një nga pesë gjuhët e njohura nga Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për gjuhët në nivelin C1.

Kandidatët për pedagogë duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme :

1. Të kenë zotësi të plotë veprimi, aftësi të punës në grup, aftësi komunikimi profesional.
2. Të mos janë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.
3. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.
4. Të mos janë larguar nga USH “L.Gurakuqi” pa miratimin e këtij të fundit.
5. Të mos kenë prishur në mënyrë publike imazhin e USH “L.Gurakuqi”.
6. Të mos kenë lidhje familjare (bashkëshort/bashkjetues, bir, bijë dhe fëmijët e tyre), gjinie (prindër, motër e vëlla dhe fëmijët e tyre, emtë a ungi) apo krushqie (prind, fëmijë,

vëlla/motër i/e bashkëshortit/es dhe bashkëshort/bashkëjetues i fëmijëve) me punonjës egzistues brenda të njëjtës njësi bazë apo ndihmëse ku kërkojnë të punësohen.

Kandidatët për pedagogë duhet të paraqesin këto dokumente :

1. Të aplikojë “on-line” në faqen zyrtare të USH në internet në adresen www.unishk.edu.al (rubrika lidhje të shpejta)
2. Letër-motivimi dhe jetëshkrim (CV) me foto personale.
3. Fotokopje të noterizuara të diplomave universitare (Bachelor dhe MSH ose MIND) në specjalitetin e lartpërmendur dhe lista përkatëse e notave të noterizuara. Për diplomat e fituara në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet certifikata e njohjes nga MASR.
4. Fotokopje e noterizuar e gradës shkencore “Doktor” në specialitetin e lartpërmendur dhe/ose titujve akademikë (nëse ka të tilla).
5. Dy rekomandime nga të cilat të paktën një prej mësimdhënësit me tituj shkencorë në profilin përkatës dhe një rekomandim nga punëdhënësi i fundit.
6. Fotokopje të artikujve të botuar, teksteve universitare apo parauniversitare, projekte shkencore, punime të tjera.
7. Dëshmi e gjuhës së huaj të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore (niveli C1) ose fotokopje e noterizuar.
8. Dëshmi për kualifikime të ndryshme, pjesëmarrje në konferanca, seminare, workshop etj.
9. Dëshmi e gjendjes gjyqsore (dëshmi penaliteti + vërtetim gjykate + vërtetim prokurorie + vërtetim nga zyra e përmbarimit)
10. Dëshmi e gjendjes mjeksore (kartë shëndeti + librezë shëndetsore + raport mjeko-ligjor për aftësi në punë)
11. Vërtetim nga qëndra e punës në të cilën ka punuar ose punon (fotokopje e noterizuar e librezës së punës) dhe/ose vërtetim papunësie nga Zyra e punës.
12. Deklaratë që provon kushtet e pikës 3/c të nenit 8 të rregullores së posaçme të Universitetit “Për zënien dhe ruajtjen e vendit të punës” (për mos-lidhje farefisnore).
13. Certifikatë familjare dhe fotokopje e pasaportës ose letërnjoftimit ID.
14. Vërtetim rajoni për adresen/rezidencen e banimit (kontratë qiramarrije).

Shënim :

- Kontrata e punës do të jetë me afat 1 – vjeçar (vit akademik) me të drejtë rinnovimi.
- Kandidatët duhet të dorëzojnë me postë ose pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore, dokumentacionin e mësipërm bashkë me një listë përbledhëse të këtij dokumentacioni të firmosur, brenda dy javëve nga publikimi i njoftimit në Buletinini e Agjensisë së Prokurimit Publik.
- Konkursi do të zhvillohet me dosje, dhe/ose testim, dhe/ose intervistë brenda tri javëve nga publikimi i njoftimit, sipas orarit që do të përcaktojë Departamenti i Biologjisë dhe kimisë.
- Kandidatët që kualifikohen do të njofshen me e-mail nga kryetari i komisionit ad-hoc.
- Për hollësi të mëtejshme, si programi, mënyra e zhvillimit të konkursit dhe ora e saktë, t'i drejtoheni Dekanatit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe/ose Sektorit të Burimeve Njerëzore.

